

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare 2017-2020

**Nga të dhënat në informacion
Nga informacioni në vendimarrje**

Mirela Muça

20 Prill, 2016

Çfarë paraqet Programi i Statistikave Zyrtare?

- Detyrimin ligjor të iNSTAT, përcaktuar nga Ligji për Statistikat Zyrtare Nr.9180, date 05.02.2004
- Dokument referues për acquis në statistika
- Dokumenti i përditesuar me legjislacionin e ri dhe zhvillime të tjera relevante për statistikën, Shqiptare dhe Evropiane
- Dokument i cili reflekton bazën ligjore, metodologjike, dhe instrumentat, të cilat do të ndikojnë në mënyrën si si do të prodhohen statistikat zyrtare në Shqipëri.

Rroli i INSTAT ne hartimin dhe zbatimin e PSZ


- INSTAT është përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e SKS (*neni 7, pika 1*):
 - Hartimi i PSZ është pjesë e rolit si koordinator i SKS të INSTAT
 - Bashkëpunimin me agjencitë statistikore për projektimin dhe zbatimin e programit;
 - Sigurimin e uniformitetit të metodologjisë së përdorur gjatë kryerjes së vrojtimeve statistikore;
 - Sigurimin e mbështetjes teknike në mënyrë që veprimtaria statistikore të përputhet me standardet ndërkombëtare;
 - Kontrollimin e zbatimit të cilësisë statistikore sipas parimeve të statistikave;
 - Pjesëmarrjen në proceset e krijimit të sistemeve kombëtare statistikore të informatizimit;
 - Përfaqësimin e SKS në sistemin statistikor evropian dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe mbajtjen e marrëdhënieve me institutet kombëtare të statistikave të vendeve të tjera.
- INSTAT është përgjegjës për të siguruar zbatimin e PSZ të miratuar si dhe që statistikat në PSZ janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas parimeve statistikore (*neni 7, pika 2/b dhe c*).

Procesi i hartimit të programit dhe kalendari i aktiviteteve të parashikuara

- Ngritja e Grupit të Punës në INSTAT; - Mars 2016
- Ngritja e Grupeve Teknike të Punës për çdo fushë statistikore; - Mars 2016
- Sigurimi i mbështetjes së Partnerëve (UNICEF; UNWomen Sida etj) Mars 2016
- Punë përgatitore e grupeve teknike për konsultimin e Compendium-it dhe përgatitjen e strukturës së PSZ (Compendiumit 2015 & Dokumenti strategjik) – Prill 2016
- Lancimi i procesit të hartimit të PSZ - **20 Prill 2016**
- **Procesi i konsultimit - Mbledhjet e Grupeve Teknike të Punës (bilaterale ose sipas fushave) Maj 2016**
- Përgatitja e draftit të parë të PSZ – 15 Qershor 2015
- Konsultimi i Draftit të parë (PSZ) me Këshillin e Statistikave
- Qarkullimi për mendim i draftit të parë të PSZ tek institucionet – Qershor 2016
- Reflektimi i sugjerimeve/komenteve në Draftin Final – Korrik/Gusht 2016
- Qarkullimi i Draftit Final në komisionet parlamentare – Shtator 2016
- Miratimi i Dokumentit të PSZ-së në Parlament – **Shtator/Tetor 2016**

Parimmbi te cilat do te ndertojme programin Statistikor 2017-2021

- Proces transparent dhe gjithëpërfshirës
- Program (PSZ) dinamik (reflekton ndryshimet ligjore, metodologjike dhe instrumentat)
- Dokument konsensual (përfshirë prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave)



Çfarë do të synojmë në 5 vitet e ardhëshme?

- **Shperndarjen e statistikave sa më afër përdoruesit**
 - Nje kuptim me te mire te nevojave te perdoruesit
 - INSTAT një partner i mire i përdorueseve dhe lider i prodhimit te statistikave
 - Ndërtimi i aleancave strategjike me perdoruesit publik dhe privat
 - Nje strategji e re komunikimi me përdoruesit
 - Krijimi i një qendre burimore përdorimi (Qendra e trajnimit)
 - Promovimi i INSTAT si një brand
- **Cilësinë**
 - Zbatimi i kodit të praktikave
 - Fuqizimi i menaxhimit cilësisë
 - Burime të besueshme për të dhëna cilesore
 - Promovimi i cilësisë së statistikave zyrtare
- **Burime të reja informacioni**
 - Burime te reja të dhënash
 - Përmirësim i teknologjisë dhe adoptimi i metodologjive bashkëkohore
 - Në vazhdimsi përmirësim i metodave të mbledhjes së të dhënave
- **Procese të standartizuar të prodhimit të statistikave**
 - Identifikim dhe implementim i standarteve te reja te prodhimit te statistikave
 - Përdorim sa më i gjerë i mikrodatave duke respektuar rigorozisht konfidencialitetin

Si mendojmë që t'ia arrijmë?

- Bashkëpunim –komunikim me partnerët - Një proces pjesmarres dhe gjithëpërfshirës në planifikim dhe implementim të Programit
- Transparencë/pavarsi për të rritur besimin e publikut tek SKS
- Prioritizimi i aksioneve dhe inisiativave;
- Përgjegjësi dhe të drejta të qarta të institucioneve
- Përmirësimi i kapaciteteve njerzore, materiale, financiare, teknologjike
- Bazë ligjore e përshtatëshme
- Sigurimi/diversifikimi i një portofoli optimal për prodhimin e statistikave cilësore

Përmbajtja e programit (*neni 6, pika 3*)

- Përshkrimi i statistikave zyrtare dhe treguesit;
- Institucionet përgjegjëse për prodhimin/shpërndarjen e statistikave zyrtare;
- Klasifikimet që përdoren;
- Nivelin e disponueshmërisë për publikun (nivel kombëtar, rajoni, bashkie);
- Frekuencën e prodhimit dhe publikimit;
- Vitin në të cilin do të prodhohen/shpërndahen treguesit;
- Vitin në të cilin do të shpërndahen për herë të parë treguesit e rinj;
- Listën e burimeve të përdorura për prodhimin e statistikave, (administrative ose vrojtime);
- Burime të tjera (regjistrat, regjistrimet ose të dhëna të tjera)
- Listën e aktiviteteve statistikore vrojtimeve dhe kalendarin

Struktura e Programit

- **Struktura e metodologjike: Udhërrëfyes - Compendium 2015**

“Compendium i Eurostat” - është një dokument që përmbledh kërkesat e prodhimit statistikor, i cili shërben si dokument referimi për acquis në statistika. Ky dokument përmbledh informacionin kryesor të referimit për prodhimin e statistikave evropiane, duke marrë parasysh legjislacionin e përditësuar dhe zhvillime të tjera të rëndësishme për statistikat evropiane. Ky dokument rishikohet dhe përditësohet çdo vit.

- **Dokumenti strategjik:** Përcakton drejtimet strategjike të zhvillimit të Statistikave – Vizionin dhe vlerat; Objektivat strategjik; Aktivitetet kryesore për arritjen e objektivave

Fushat prioritare te organizimit te Statistikave

- Fusha 01 : Statistikat e Evropës 2020
- Fusha 02 : Statistikat e Qeverisjes Ekonomike
- Fusha 04 : Statistikat e Performancës Ekonomike dhe Sociale
- Fusha 05 : Statistikat e Qendrueshmërisë Mjedisore
- Fusha 06 : Statistikat e Biznesit
- Fusha 07 : Statistikat e Popullsisë së Evropës
- Fusha 08 : Statistikat Gjeohapësinore, mjedisit, bujqësia dhe statistika të tjera sektoriale
- Fusha 11 : Statistikat shumëqëllimore dhe efienca e fituar në prodhim
- Module të tjera

Elemente te rendesishem per cdo fushe

- Kodi, Fusha, Moduli, Emertimi dhe pershkrimi i aktivitetit;
- Treguesit statistikore;
- Vitet kur do te kryhet aktiviteti;
- Vitet kur do të publikohet aktiviteti;
- Frekuenca e kryerjes së aktivitetit;
- Niveli i shpërndarjes;
- Agjencia statistikore përgjegjëse për kryerjen e aktivitetit;
- Burimet e informacionit dhe institucionet përgjegjëse qe duhet te japin te dhena;
- Frekuenca, format e bashkeveprimit dhe metoda e transmetimit te te dhenave midis institucioneve;



Ju faleminderit

mmuca@instat.gov.al